



Datë: 02.06.2025
Numër Protokolli: 5380/2025

A.nr.704/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.704/2025 të datës 23.04.2025 të parashtruar nga ankuesja R.J, kundër organit të punësimit/Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike ‘*kompensim material*’, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 02.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa më numër A.nr.704/2025, e datës 23.04.2025, e parashtruar nga ankuesja R.J.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.455/2025, i datës 21.03.2025, i Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile R.J (*tutje referuar vetëm ankuesja*), më datë 23.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.455/2025, të 21.03.2025, të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ,me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 2687/2025 të datës 23.04.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.455/2025, të 21.03.2025, të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Vendimin A.nr.2095/2024 të datës 27.02.2025 të KPMSHCK-së; Vendimin A.nr.1417/2024 të KPMSHCK-së; Vendimin me Nr.89/2024, të datës 27.11.2024, të zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 20.02.2024; Ankesën me numër protokolli 7056/2024 të datës 24.12.2024 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën me numër protokolli 4908/2024 të datës 18.09.2024 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e ankueses e datës 22.08.2024 për B.C; Emailin e datës 17.07.2024 për ankuesen nga Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore i MPB; Emailin e datës 16.07.2024 nga ankuesja për A.G; Emailin e datës 19.03.2024 nga S.M për Xh.G; Emailin e datës 19.03.2024 nga Xh.G për S.M; Emailin e datës 27.09.2023 dhe 22.02.2024 nga ankuesja për Xh.G;

Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 20.02.2024; Emailin e datës 16.12.2024 nga ankuesja lidhur me dërgimin e raportit javor; Emailin e datës 05.12.2024 nga Xh.G për ankueses për zëvendësim me rastin e pushimit vjetor nga data 05-20.12.2024; Emailin e datës 17.12.2024 nga ankuesja për A.M lidhur me raportin javor 09-13.12.2024; Emailin e datës 30.09.2024 nga Xh.G lidhur me raportin javor nga G.C-M; Dëshmi për caktimin ushtruese e detyrës nga data 04-15.03.2024 për ankuesen nga Rims MPB; Dëshmi për caktimin ushtruese e detyrës nga data 017.08.2023 deri 06.09.2023 për ankuesen nga Rims MPB; Dëshmi për caktimin ushtruese e detyrës nga data 05-19.06.2024 për ankuesen nga Rims MPB; Emailin e datës 30.09.2024 lidhur me raportin mujor të zyrtares G.C-M; Kopjen e ID-së së ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 30.12.2024; Përgjigjen në ankesë e datës 10.01.2025; Ndryshimi i Aktit të Emërimit i datës 1802.2020; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtare e Lartë për regjistrim të Automjeteve i datës 27.04.2015.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur së ankesa e ankueses, **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton së ankuesja është e punësuar në pozitën *Zyrtare e Lartë për Regjistrim të Automjeteve*, Sektori për Regjistrim të Automjeteve, pranë Agjencisë për Regjistrim Civil/ Ministria e Punëve të Brendshme.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rrjedhë së ankuesja më datë 27.09.2023, i është drejtuar më kërkesë mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë për lëshimin e aktit lidhur me detyrat që është duke ushtruar tani e një vit, për zyrtaren G.C-M, e cila gjendet në shfrytëzim të pushimit të lehonisë. Ankuesja serish më datë 22.02.2024 dhe më datë 22.08.2024, ka parashtruar kërkesë tek u.d Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit Civil me të cilën ka kërkuar që të nxirret vendim për kompensim lidhur me punët e kryera, për zyrtaren që gjendet në pushim të lehonisë.

Meqenëse ankuesja nuk ka pranuar përgjigje në kërkesën e saj të datës 22.08.2024, e njëjta ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilën ka kërkuar nxjerrjen e vendimit në lidhje me shtesën për vëllim në punë, ndërsa, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.11.2024 ka nxjerr Vendim A.nr.1417/2024, me të cilin ka aprovuar ankesën e ankueses, duke e detyruar Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil që të shqyrtoj kërkesën e ankueses të datës 22.08.2024.

Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit Civil, më datë 27.11.2024 ka nxjerr Vendim me Nr.89/2024, me të cilin ka refuzuar kërkesën e datës 22.08.2024 të ankueses, me arsyetimin se detyrat që ja ka ngarkuar mbikëqyrësi nuk tejkalojnë 5% e punëve sipas përshkrimit të detyrave të punës dhe sipas përshkrimit mbikëqyrësi mund ti jap detyra shtesë, po ashtu ,nuk janë plotësuar kushtet për marrëveshje për vëllim të shtuar. Ankuesja serish parashtron ankesë në Këshill, ndërsa, ky i fundit, më Vendimin A.nr.095/2024, të datës 27.02.2025 ka aprovuar ankesën e ankueses, duke anuluar Vendimit me Nr.89/2024, të datës 27.11.2024, dhe duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit A.nr.095/2024, të datës 27.02.2025, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 21.03.2025 ka nxjerr Vendimin Nr. 455/2025, përmes të cilit ka refuzuar kërkesën e ankueses të datës 22.08.2024, akt të cilën ankuesja e kundërshton serish më ankesë duke pretenduar se ka zëvendësuar kolegen për një periudhë të gjatë kohore prej dy vitesh, dhe së e njëjta ka të drejtë në kompensim për punë shtesë.

Kolegji i Këshillit, në shqyrtim të pretendimeve ankimore të ankueses, të ndërlidhura me provat materiale, ju referuar Ligjit Nr. 08/L196 për Pagat në Sektorin Publikë, gjegjësisht:

-Nenit 13, i cili përcakton: *Paga e nëpunëses/it civile përbëhet nga paga bazë, shtesat dhe kompensimet, kur shtesat dhe kompensimet janë të aplikueshme sipas këtij ligji.*

-Nenit 22 paragrafi 1, i cili përcakton: *1. Shtesat që mund përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. shtesa e veçantë për të zgjedhurat/it; 1.2. shtesa për kushte tregu të punës; 1.3. shtesa e performancës; 1.4. shtesa për kushte specifike të punës; 1.5. shtesa për punën pa orar të paracaktuar; 1.6. shtesa për vëllimin e punës; 1.7. shtesa për licencë të avancuar për nëpunësen/in e arsimit para universitar; 1.8. shtesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor; 1.9. shtesa e performancës për krijuesen/in dhe performuesen/in e artit dhe kulturës; 1.10. shtesa funksionale.*

-Nenit 28 ku përcaktohet se: *1. Organizatat buxhetore, në rastet e parashikuara nga ky ligj, mund të japin shtesën për vëllim të punës, për kryerjen e punës për shkak të rritjes së vëllimit të punës, nëse kanë mjete në dispozicion për këtë qëllim nga kursimet e fondeve të pagave që krijohen për shkak të mungesës së nëpunëseve/ve civil, apo pozitive të paplotësuara për të cilat janë paraparë mjete në planin financiar të shfrytëzuesit buxhetor dhe fonde për projekte të veçanta. 2. Nëpunëset/it civil përfitojnë shtesën për shkak të rritjes së vëllimit të punës, për punën e kryer dhe që tejkalon rezultatet e pritshme të punës në një (1) muaj, nëse në këtë mënyrë është e mundur të sigurohet një mënyrë më racionale arritja e rezultateve të punës si dhe buxheti. 3. Shtesa për vëllimin e punës miratohet nga zyrtarja/i kryesor administrativ i institucionit, pas marrëveshjes me nëpunësen/in civil për të punuar me vëllim të shtuar. 4. Shtesa e përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni, nuk mund të jetë më e lartë se 0.5% e fondeve totale të përdorura nga organizata buxhetore, për pagën bazë të zyrtareve/ëve publik të organizatës buxhetore në të njëjtin vit financiar.*

Po ashtu për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me çështjen, Kolegji ju referua edhe Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, gjegjësisht nenit 8 paragrafi 1 dhe 2, ku parashihet se: *1. Organizatat buxhetore, mund të japin shtesën për vëllim të punës, për kryerjen e punës për shkak të rritjes së vëllimit të punës, nëse kanë mjete në dispozicion për këtë qëllim nga kursimet e fondeve të pagave që krijohen për shkak të mungesës së nëpunëseve civil, apo pozitive të paplotësuara për të cilat janë paraparë mjete në planin financiar të shfrytëzuesit buxhetor dhe fonde për projekte të veçanta. 2. Shtesa për vëllimin e punës përfitohet nga nëpunësit civil, për punën e kryer për shkak të rritjes së vëllimit të punës dhe që tejkalon rezultatet e pritshme të punës në një (1) muaj, dhe nenit 9 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet: 1. Shtesa për vëllimin e punës mund të përfitohet nëse në këtë mënyrë është e mundur të sigurohet në mënyrë më racionale arritja e rezultateve të punës, si dhe buxheti. 2. Udhëheqësi i Njësisë dhe/apo Zyrtari Kryesor Administrativ mund t'i kërkojë një apo më shumë nëpunësve civil që të angazhohen me vëllim të shtuar të punës për një periudhë të caktuar kohore që nuk e tejkalon një (1) vit.*

Referuar bazës ligjore si më sipër, Kolegji thekson faktin së Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë ka hyrë në fuqi më datë 05.02.2023, ndërsa, Rregullorja (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik ka hyrë në fuqi më datë 06.02.2023, andaj, duke marrë parasysh periudhën kohore për të cilën ankuesja pretendon se ka kryer detyrat e koleges që ka qenë në pushim të lehonisë gjegjësisht nga data 26.07.2022 deri më datë 06.09.2024, Kolegji vlerëson se shtesa për vëllim në punë për periudhën nga data 26.07.2022 deri me 06.02.2023, nuk mund të aplikohet sepse gjatë kësaj periudhe legjislacioni i aplikueshëm për pagat në shërbim civil (Ligji Nr.149/202), nuk ka paraparë një kompensim të tillë, ndërsa ,lidhur me periudhën nga data 05.02.2026 kur ka filluar të aplikohet Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë dhe Rregullorja (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, e deri me datë 06.09.2024 si datë ku pretendohet se ankuesja ka ushtruar punë me vëllim shtesë, Kolegji nga provat materiale nuk ka gjetur dëshmi që vërtetojnë faktin që lidhur me ushtrimin e punëve shtesë nga ankuesja të jetë lidhur marrëveshje mes ankueses dhe Zyrtarit Kryesor Administrativ, si një nga parakushte kryesore për kompensim të shtresës për vëllim në punë, kështu që mbi këtë bazë, marrëveshja për vëllim shtesë në punë nuk mund të lidhet për kohën tashme të ndodhur (retroatvisht), andaj, edhe pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Për me tepër, referuar provave materiale të lëndës, ankuesja nuk ka ofruar dëshmi që vërtetojnë faktin që e njëjta gjatë periudhe kontestues kishte parashtruar kërkesë apo mjet të rregullt juridik në drejtim

të realizimit të kompensimit të pretenduar si në ankesë. Kështu që, përfundimisht Kolegji i Këshillit vlerëson se në mungesë të marrëveshjes për vëllim shtesë ankuesja nuk mund të realizoj kompensimin për vëllim shtesë të punës pasi që nuk janë plotësuar kërkesat ligjore të përcaktuar më dispozitat materiale që rregullojeni çështjen e shtesës për vëllim në punë.

Andaj, mbi gjendjen e fakteve dhe rrethanave ligjore si më sipër, rrjedhë së Vendimi Nr.455/2025, i datës 21.03.2025, i Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është vendim i ligjshëm dhe i nxjerr në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, dhe së në kuptim të dispozitave të nenit 18, paragrafi, 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.704/2025

Avdyl BEKTESHI

Ardita Haxhnikaj DEMI

Procesmbajtës

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses R.J;*
- *Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të MPB; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*